VENDIM
Nr.873, datë 18.6.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.78, DATË 4.2.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASËN, KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRFITIMIT TË NJË PAKETE TË VEÇANTË HIGJIENO-SANITARE, PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr.78, datë 4.2.2007 të Këshillit të Ministrave, fjalët "…në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj…" zëvendësohen me "…në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj…".

2. Efektet financiare, prej 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekësh, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2008, grupi 25, titulli 064, kapitulli 1, artikulli 606, zëri "Transferta të familjeve dhe të individëve", miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha